

UNITETI - DOMOSDOSHMERI E PËRJETSHME PËR MYSLIMANËT

Haxhi Shejkh Vullnet MERJA

Prej çështjeve të rëndësishme dhe më e përfolura në këto ditë është ajo e unitetit islam. Uniteti dëshmohet në ligjin islam dhe i ka rrënjët në këtë ligj. Allahu i Madhëruar thotë në Kur'anin e Shenjtë: **"Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kur'anin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu ua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë."** (Sure "Ali Imran", ajeti 103.)

Ajeti i bekuar flet qartë për unitetin dhe zhdukjen e mosmarrëveshjeve mes myslimanëve. Ai i fton të gjithë myslimanët pa dallim race, ngjyre, kombi dhe gjuhe, që të kapen pas litarit të Allahut. E litari i Allahut është Islami Libri i Tij. Moszbatimi i këtij urdhri çon në përçarje dhe dalëngadalë në shkatërrim. Allahu i Plotfuqishëm na ka mirësuar me Islamin, i cili na bashkon të gjithëve, edhe pse ndryshojmë në gjuhë, në kombe dhe ngjyrë. Me ardhjen e profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!), Allahu i udhëzoi njerëzit në rrugën e drejtë dhe i nxori ata nga errësirat në dritë - në dritën e Islamit, që është feja e humanizmit, e mëshirës dhe e paqes.

Në Kur'anin e Shenjtë ka shumë ajete që flasin për unitetin dhe që i qortojnë përçarjen dhe mosmarrëveshjet. Ja disa nga këto ajete:

"Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbisni guximin e do t'ju lërë fuqia! Bëhuni të durueshëm sepse Allahu, me të vërtetë, është me të durimtarët." (Sure "Enfal", ajeti 46.)

Dhe: **"Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër. Prandaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni."** (Sure "Huxhurat", ajeti 10.)

Dhe: **"Le të dalë prej jush një grup që të ftojë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit."** (Sure "Ali Imran", ajeti 104)

Dhe: **"Mos u bëni si ata që, pasi u erdhën provat e qarta, u përçanë dhe u grindën. Për këta do të ketë dënim të madh."** (Sure "Ali Imran", ajeti 105.)

Dhe: **"Me të vërtetë, ti s'ke të bësh fare me ata që e përçajnë fenë e tyre dhe shndërrohen në sekte. Tek Allahu është puna e tyre e pastaj Ai do t'u tregojë çfarë patën punuar."** (Sure "En'am", ajeti 159.)

Dhe: **"Vërtet, ky ymeti juaj (kjo bashkësia juaj) është një i vetëm, ndërsa Unë jam Zoti juaj. Prandaj kini frikë prej Meje!"** (Sure "Mu'minun", ajeti 52.)

Ka edhe shumë hadithe të cilat paralajmërojnë dhe qortojnë përcarjen. Ato na ftojnë t'i shmangim shkaqet që çojnë në përcarje. Ja disa nga këto shkaqe:

HERETIZMI I MYSLIMANIT

Heretizmi është prej faktorëve më të rrezikshëm. Ai është muri pengues i dialogut, që ka si qëllim arritjen tek e vërteta. Ai çon në nxjerrjen nga feja dhe në shkëputjen e vazhdimësisë. Ka hadithe që e ndalojnë këtë veprim. Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *“Nëse një njeri i thotë vëllait të tij ‘O i pafe!’, është njëlloj si ta vrasësh atë.”* (El Mexhlisij, *Biharul Anuar*: vëll. 69, f. 209.)

Bilal Habeshiu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka transmetuar se profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *“O Bilal! Thirri njerëzit dhe thuaju: ‘Kush thotë se Zoti është Një e i Vetëm, një vit, një muaj, një javë, një ditë a një orë para se të vdesë, hyn në Xhenet.’* (Mutekij Hindit, *Kenzul Ummal*: vëll. 1, f. 64.)

Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *“Njeriu njihet me atë që rri. Ai që thotë ‘La il-lahe il-lall-llah’, hyn në Xhenet.”* (Ali ibn Junus el Amilij, *Es Siratul Mustekijm*: vëll. 1, f. 199.)

KONFLIKTI MES MYSLIMANËVE

Konflikti është prej veprave që çojnë në shkatërrimin e ymetit e të fesë. Ka shumë hadithe të cilat e ndalojnë konfliktin mes myslimanëve. Në Hytben (fjalimin) e Lamtumirës, Profeti Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka thënë: *“Me të vërtetë, gjaku, pasuria dhe nderi juaj janë të shenjtë për ju, njëlloj si shenjtëria e kësaj dite për ju, e këtij muaji dhe e këtij qyteti. Ju do të takoheni me Zotin tuaj dhe do t’ju pyesë për punët tuaja. Mos u ktheni pas meje e të vrisni njëri-tjetrin. Vallë, a e përçolla mesazhin? Sigurisht, i pranishmi të informojë atë që nuk është këtu prej jush.”* (Sejjid Muhsin Emijni, A’janu Shia: vëll. 1, f. 290.)

Imam Khomeini ka thënë: *“Ajo gjuhë, prej së cilës del mosmarrëveshja, është gjuhë e shejtanit.”* Dhe: *“Përcarja është prej shejtanit, ndërsa bashkimi është prej Rrahmanit.”* Sa letrare dhe domethënëse janë këto thënie të imamit,

Të dashur myslimanë besimtarë! Është detyrë e jona të largohemi nga përcarja, sepse ajo është frymëzim i shejtanit. Nëse përplasemi me njëri-tjetrin, ne nuk fitojmë asgjë. Janë të tjerët që përfitojnë prej situatës tonë konfliktuale. Nëse ndryshojmë në mendim e në veprim, duhet të ulemi e të dialogojmë, t’i vendosim problemet tona mbi tavolinën e dialogut dhe t’i zgjidhim ato me qetësi. Nëse konfliktohem me njëri-tjetrin, kur unë e quaj aksh njeri të pafe dhe ai më quan të pafe, të gjithë ne do bëhemi të padëshiruar te njerëzit dhe njerëzit do të largohen nga feja. Nëse e kuptojmë mirë rrezikun e përcarjes, çdo mysliman duhet të mbajë përgjegjësinë e mbrojtjes së ymetit dhe të unitetit të tij. Të gjithë duhet të përpiqen që t’i ndalojnë konfliktet dhe

mosmarrëveshjet. Të gjithë duhet ta kuptojmë saktë fundin e dhembshëm që sjellin konflikti dhe përçarja si në këtë jetë, ashtu edhe në Jetën Tjetër.

Dhe ymeti islam ka fuqi ta ruajë veten nga çdo gjë e keqe. Fuqia e ymetit mysliman është te bashkimi i bijëve dhe i bijave të tij.

Edhe pse myslimanët janë të ndarë në medh'hebe (shkolla) të ndryshme e në sekte të shumta, përsëri, ato që i bashkojnë janë më të shumta se ato që i ndajnë. Pikat bashkuese përbëjnë bazat e fesë së tyre.

Edhe pse situata e unitetit është kritike në këto ditë, ka rrugë që ai të ripërtërihet dhe të forcohet. Disa nga këto janë:

KUR'ANI I SHENJTË

Është për të ardhur keq, se fatkeqësitë dhe problemet e shumta të myslimanëve në këto ditë janë për shkak të lënies pas dore të Kur'anit dhe zbatimit të rregullave të vendosura nga njerëzit. A nuk themi ne se jemi ymeti i profetit Muhamed? A nuk themi ne se ai ishte Kur'ani folës? Sa e ndjekim dhe e zbatojmë synetin e Profetit në drejtim të Kur'anit? Myslimanët duhet të zbatojnë Kur'anin. Kur'ani përmban çdo gjë që ka lidhje me jetën e njerëzve në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Në të gjendet rruga e edukimit, e përsosurisë dhe e vlerave më të larta.

Kur'ani i Shenjtë është burimi bazë i unitetit islam, sepse Kur'ani është Libri i të gjithë myslimanëve. Me ajetet e tij të shumta, ai i fton për unitet dhe për braktisjen e mosmarrëveshjeve dhe të konflikteve. Është detyrë e myslimanëve që të mos largohen nga Kur'ani dhe të mos e kujtojnë atë vetëm nëpër ceremoni të ndryshme. Ata duhet të jetojnë me Kur'anin. Kur'ani është Libri i jetës dhe sqaruesi i gjithçkaje.

Ne jemi krenarë me Islamin dhe me Kur'anin, të cilët ftojnë jo vetëm për unitetin e myslimanëve, por për unitetin e mbarë njerëzimit, me thirrjen: *"Zoti është Një e s'ka tjetër dhe Muhamedi është rob i Tij dhe i Dërguari i Tij."*

PERSONALITETI I PROFETIT MUHAMED

(paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!)

Profeti Muhamed, vula e profetëve është personaliteti që i bashkon myslimanët. Të gjithë myslimanët janë të një mendimi se ai është udhëheqësi i parë i tyre. Ai është modeli më i plotë dhe shembulli i përkryer. Ai ftoi që myslimanët të jenë gjithmonë një dorë e vetme dhe e përbashkët kundër armiqve të tyre.

Profeti dëshironte që mbarë njerëzia të jetonte nën hijen e unitetit e të bashkimit. Thirrja e Profetit është mësim për ne, që të zhdukim përgjithmonë mosmarrëveshjet mes nesh. A ka më të mirë sesa mbjellja e farës së unitetit dhe të bashkimit në zemrat e brezave të rinj të myslimanëve?

A ka gjë më të keqe sesa rritja dhe edukimi i brezave me frymën e përçarjes dhe të armiqësisë për njëri-tjetrin? A e pyesim ndonjëherë veten se çfarë fitojmë nga përçarja? Vallë, Kur'anin dhe Profetin, Allahu i dërgoi për bashkim a për përçarje?!

HAXHI

Haxhi është vendi dhe koha ku shihet e praktikohet të jetuarit në unitet. Haxhi është vendi dhe koha, ku duket madhështia materiale dhe shpirtërore e myslimanëve dhe fuqia e myslimanëve. Haxhi është si Kur'ani. Nga haxhi përfitojnë të gjithë.

Haxhi është detyrë, që ka caktuar Allahu. Ai ka përmasa të mëdha bashkuese dhe unifikuese. Ai është kongresi i madh i myslimanëve për të katër anët e botës. Asnjë shtet në botë nuk ka mundësi që të organizojë një tubim kaq madhështor. Myslimanët edhe pse mund të ndryshojnë në mendime, i bashkon një Kible dhe një Shtëpi (Qabja), adhurimi i Allahut të Vetëm e të Pashoq dhe pasimi i synetit të profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Është detyrë e myslimanëve që të përfitojnë sa më shumë dhe të forcojnë sa më shumë rreshtat e unitetit pas mbarimit të haxhit. Një ndër detyrat e këtij tubimi madhështor, është thirrja për bashkim dhe zhdukja e mosmarrëveshjeve mes myslimanëve.

Është detyrë e dijetarëve që të futen sa më thellë në detin e njohjes së dhembjeve të ymetit islam dhe të përpiqen që t'i largojnë këto dhembje prej tij. Përderisa ata janë trashëgimtarët e profetëve në udhëzimin e njerëzve, duhet të jenë të pajisur me margaritarët e urtësisë dhe të udhërrëfimit, me qëllim që njerëzit të dallojnë nëpërmjet tyre rrugën e drejtë e të vërtetë.

Është detyrë e oratorëve dhe e autorëve të librave që të ndihmojnë në forcimin e unitetit dhe të vëllazërisë islame, që fjala e Allahut të jetë më e larta dhe ajo e shejtanit të jetë më e ulëta.

Do të donim t'i mbyllnim këta rreshta me thënien e Allahut të Madhëruar, në Kur'anin e Shenjtë: **"O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja! Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit! Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur."** (Sure "Nisa", ajeti 59.)